



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS - KONFERENCA PËR PERSONAT ME  
AFTËSI TË KUFIZUAR**

*11 qershor 2012*

Ambasadori Cannon,  
Komisionerja Baraku,  
Z. Lule,  
Të nderuar miq,  
Zonja dhe zotërinj,

Jam shumë i lumtur që ndodhem këtu me ju sot në cilësinë e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për të filluar një javë të re përkushtuar personave me aftësi të kufizuara.

Veprimtaria e sotme shënon guximin dhe angazhimin e të rinjve me aftësi të kufizuara për të themeluar Forumin e të Rinjve me Aftësi të Kufizuara që përfaqëson interesat e të rinjve shqiptarë me aftësi të kufizuara.

Më ka bërë shumë përshtypje progresi i Forumit në zhvillimin e objektivave të misionit të vet dhe në planifikimin e aktiviteteve të projektit.

Dua të përgëzoj edhe përqasjen proaktive të Forumit në rritjen e ndërgjegjësimit publik në lidhje me sfidat që hasin personat me aftësi të kufizuara – ndërgjegjësim aq shumë i nevojshëm.

Përfshirja e plotë në shoqëri e të rinjve me aftësi të kufizuara është gjithashtu çështje e të drejtave të njeriut, dhe nëse mund ta shtoj, edhe një çështje e demokracisë. Në fund të fundit, kjo ka të bëjë me ndërtimin e një shoqërie demokratike më të mirë dhe të vërtetë, që respekton të drejtat e të gjithë qytetarëve.

Megjithatë, të rinjtë me aftësi të kufizuara ende hasin shumë sfida gjatë kontributeve të tyre në jetën publike.

Ata përballen me probleme të shumta si pengesa fizike apo aksesit në arsim, kujdes mjekësor dhe punësim. Edhe pjesëmarrja e tyre në jetën kulturore dhe politike është e kufizuar, dhe kjo do të ishte në dëm të çdo shoqërie të zhvilluar.

Ata duhen fuqizuar për të marrë kontrollin e plotë të jetëve të tyre dhe, e thënë me një fjalë, të kuptojnë potencialin e tyre më të mirë njerëzor. Dhe për këtë meritojnë mbështetje.

Për këtë arsye, dëshiroj të përgëzoj Forumin për nismën dhe energjinë që tregojnë.

E di që kanë shumë ide të mira se si të adresojnë sfidat me të cilat përballen. Prezenca përshëndet këto përpjekje të larta të drejtuara nga shoqëria civile.

Kjo na sjell natyrshëm te veprimtaria e sotme.

Zonja dhe zotërinj,

Veprimtaria e sotme organizohet si pjesë e projektit të Prezencës *Mbështetje e Nismës Rinore të Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri*, në bashkëpunim me Forumin për të Rinjtë me Aftësi të Kufizuara, British Council dhe me Fondacionin Vodafone, në kuadrin e Promovimit të Javës së Përfshirjes.

Do të doja të shprehja vlerësimin më të ngrohtë për Ambasadën e Britanisë në Tiranë, British Council në Shqipëri dhe Fondacionin Vodafone për mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

Bashkëpunimi ynë i ngushtë filloi në vitin 2010, si pjesë e një projekti të Prezencës së OSBE-së, që kishte për qëllim përforcimin e Këshillit Kombëtar Shqiptar për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Prezenca e OSBE-së ka punuar vazhdimisht për të vendosur në fokus çështjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në vendimmarrje, si dhe nevojën për të krijuar dialog më të fuqishëm midis shoqërisë civile dhe qeverisë.

Për këtë arsye ne kemi këmbëngulur në mbështetjen tonë ndaj lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara dhe kemi asistuar në zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Që nga miratimi i Strategjisë, në vitin 2005, kemi parë disa zhvillime pozitive si krijimi i Këshillit Kombëtar Shqiptar për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Në atë kohë qeveria i dha prioritet angazhimit për të rritur profilin dhe për të ngritur zërin e personave me aftësi të kufizuara në vendimmarrje.

Megjithatë, e vërteta është që Këshilli është takuar vetëm pak herë që nga ajo kohë.

Kështu që ka dukshëm nevojë për të përforcuar Këshillin Kombëtar, si një model funksional bashkëpunimi midis shtetit dhe shoqërisë civile, çfarë mund të kontribuojë në përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike.

Forumit për të Rinjtë me Aftësi të Kufizuara mund të luajë një rol drejtues në këtë proces, duke rritur përfaqësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara dhe duke lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri.

Shpresoj të dëgjoj rreth ideve dhe planeve të tyre për të ardhmen.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të përfundoj duke falënderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre. Ju uroj të gjithëve një ditë të suksesshme dhe frytdhënëse.

Faleminderit!

**Fund**